

VENDIM
Nr. 224, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Halim Kosova.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Halim Kosova, deputet i zonës zgjedhore, qarku Tiranë, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 11 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun Tiranë plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrit”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Tiranë, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 11 është z. Kastriot Islami.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Tiranë, kandidati i cili renditet me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) është z. Asllan Shaban Dogjani. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Halim Kosova është z. Asllan Shaban Dogjani, i cili

është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 12 (dymbëdhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.